



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 319 Datë 08.11.2023

MBI

**KËRKESAT E SHOQËRIVE PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES NDËRMJET  
PALËVE, TREN SUN SYSTEM SH.P.K., SUN BEAT SYSTEM SH.P.K., NTSP SH.P.K.,  
KORCA PHOROVOLTAIC PARK SH.P.K. DHE SHOQËRISË FURNIZUESI I  
TREGUT TË LIRË SH.A.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20 gërmat “a” dhe “ë”, nenit 24, pikat 1, 2, 3 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 15 dhe 23 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 03.09.2016; nenit 11, pika 4 të Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.11.2022, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Grupi i Punës me nr.1919/4 prot., datë 06.11.2023 “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e mosmarrëveshjes ndërmjet FTL sh.a. dhe shoqërive: TREN SUN SYSTEM SH.P.K., SUN BEAT SYSTEM sh.p.k., NTSP sh.p.k., KORCA PHOROVOLTAIC PARK sh.p.k.”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Tren Sun System” sh.p.k., nëpërmjet shkresës së protokolluar në ERE me nr. 1918 datë 13.07.2023, shoqëria “Sun Beat System” sh.p.k., nëpërmjet shkresës së protokolluar në ERE me nr. 1919 datë 13.07.2023, shoqëria “Korca Phorovoltaic Park” sh.p.k., nëpërmjet shkresës së protokolluar në ERE me nr. 1920 datë 13.07.2023, shoqëria “NTSP” sh.p.k., nëpërmjet shkresës së protokolluar në ERE me nr. 1921 datë 13.07.2023, ndër të tjera parashtrajnë kërkesën si vijon: ... “vlerësojmë/paraqesim qëndrimin tonë se duke qënë se energjia e prodhuar nga këto centrale fotovoltaike përgjatë periudhës nga 28.07.2022 deri 08.11.2022 ka shkuar për nevojat e përmbushjes së detyrimit publik, duhet të njihet dhe t’i paguhet shoqërisë”.
- Të katërta shoqëritë e sipërcituara paraqesin të njëjtën problematikë, e cila lidhet me njohjen dhe pagesën e energjisë elektrike të gjeneruar nga njësitë fotovoltaike që këto shoqëri zotërojnë përgjatë periudhës 28.07.2022 deri më datë 08.11.2022.

- ERE më datë 26.09.2023, organizoi një seancë dëgjimore, ndërmjet përfaqësuesve të shoqërive: “Tren Sun System” sh.p.k., “Sun Beat System” sh.p.k., “NTSP” sh.p.k., “Korca Phorovoltaic Park” sh.p.k., si dhe të shoqërive OSSH sh.a. dhe FTL sh.a. me objekt *“trajtimin e problematikës së ngritur nga shoqëritë (i) Tren Sun System sh.p.k., (ii) Sun Beat System sh.p.k., (iii) NTSP sh.p.k., (iv) Korca Phorovoltaic Park sh.p.k., mbi prodhimin e lëvruar dhe të pa-kontraktuar nga njësitë gjeneruese fotovoltaike në zotërim të këtyre shoqërive”*.
- Në këtë seancë dëgjimore rezultoi që shoqëritë “Tren Sun System” sh.p.k., “Sun Beat System” sh.p.k., “NTSP” sh.p.k., “Korca Photovoltaic Park” sh.p.k., nuk kishin ezauruar të gjitha hapat administrative por kishin patur një komunikim të drejtpërdrejtë për këtë problematikë me FTL sh.a., por i ishin drejtuar ERE dhe vetëm kishin vënë në dijeni FTL sh.a. Në këto rrethana ERE vlerësoi që palët të kishin një komunikim të drejtpërdrejtë duke shprehur dhe qëndrimet përkatëse.
- Shoqëria FTL sh.a. nëpërmjet shkresës me nr. 2834/4 prot., datë 11.10.2023 drejtuar shoqërisë “Tren Sun System” sh.p.k., me shkresën nr. 2834/2 prot., datë 11.10.2023 drejtuar shoqërisë “Sun Beat System” sh.p.k., me shkresën me nr. 2834/1 prot., datë 11.10.2023 drejtuar shoqërisë “Korca Phorovoltaic Park” sh.p.k., me shkresën me nr. 2834/3 prot., date 11.10.2023 drejtuar shoqërisë “NTSP” sh.p.k., ka parashtuar sa më poshtë vijon: *...”për periudhën e kërkuar 28.07.2022 - 08.11.2022 shoqëria "FTL" sh.a. nuk ka patur kontrate shitblerje të energjisë elektrike me shoqërinë... Kontrata ndërmjet shoqërisë... dhe "FTL" sh.a.... për shitblerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga centrali fotovoltaike, është lidhur me datë 28.04.2023, dhe ka hyrë në fuqi me datë 02.05.2023, datë e cila korrespondon me fillimin e operimit/ livrimit të energjisë elektrike, siç përcaktuar në Aneksin e kontratës”*
- Në vijim të këtij komunikimi shoqëritë (i) Tren Sun System sh.p.k., (ii) Sun Beat System sh.p.k., (iii) NTSP sh.p.k., (iv) Korca Photovoltaic Park sh.p.k., nëpërmjet shkresave përkatëse drejtuar në ERE kanë parashtuar si më poshtë vijon: *.....”Në vijim ne kemi paraqitur kërkesën tonë pranë FTL sh.a. për dijeni ERE dhe OSSH me datë 03.10.2023, të cilës FTL i është përgjigjur me shkresë me datë 11.10.2023. Duke qënë se nuk jemi të qartë për zgjidhjen e kërkesës tonë nga FTL, kërkojmë nga institucioni juaj që të mund ta ndiqni ju këtë çështje me FTL sh.a. në formë shkresore kërkesën tonë për njohjen dhe blerjen e energjisë së prodhuar për periudhën 28.07.2022 deri 08.11.2022. Edhe njëherë në këto kushte, kërkojmë nga ana juaj trajtimin e mëtejshëm të kërkesës sonë nga institucioni juaj”*.
- Duke qënë se palët FTL sh.a. dhe shoqëritë (i) Tren Sun System sh.p.k., (ii) Sun Beat System sh.p.k., (iii) NTSP sh.p.k., (iv) Korca Photovoltaic Park sh.p.k., të cilat ngrenë një problematikë të njëjtë për energjinë e prodhuar nga centralët fotovoltaike që zotërojnë këto shoqëri përgjatë periudhës nga 28.07.2022 deri 08.11.2022, kanë qëndrime të kundërta me FTL sh.a., ERE në mbështetje të legjislacionit në fuqi, me urdhrin nr. 102 datë 31.10.2023 ka ngritur një grup pune për të trajtuar problematikën/mosmarrëveshjen ndërmjet shoqërive: (i) Tren Sun System sh.p.k., (ii) Sun Beat System sh.p.k., (iii) NTSP sh.p.k., (iv) Korca Phorovoltaic Park sh.p.k., si dhe të shoqërisë FTL sh.a., mbi prodhimin e lëvruar dhe të pa-kontraktuar nga njësitë gjeneruese fotovoltaike të këtyre shoqërive.

- Duke marrë në konsideratë se palët (i) Tren Sun System sh.p.k., (ii) Sun Beat System sh.p.k., (iii) NTSP sh.p.k., (iv) Korca Phorovoltaic Park sh.p.k., janë të licencuara për prodhimin e energjisë elektrike dhe shoqëria dhe FTL sh.a., është e licensuar në furnizimin e energjisë elektrike, në zbatim të nenit 11 të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 08.07.2016, legjitimohen për të kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet tyre mbi prodhimin e lëvruar dhe te pa-kontraktuar nga njësitë gjeneruese fotovoltaike të shoqërive të sipërcituara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s:

### **Vendosi:**

1. Pranimin për shqyrtim nga ERE të kërkesës së paraqitur nga shoqëritë “TREN SUN SYSTEM” sh.p.k., “SUN BEAT SYSTEM” sh.p.k., “NTSP” sh.p.k., “KORCA PHOROVOLTAIC PARK” sh.p.k., për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet shoqërive dhe shoqërisë “FTL”, duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 08.7.2016.
2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**